



**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës**  
**Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës**

**Vlerësim Preliminar i Llojeve Bimore Invazive në Kosovë**

Dokument pune për identifikimin dhe vlerësimin paraprak  
të llojeve bimore invazive të Kosovës



Prishtinë, 2026

## **Përmbajtja**

Hyrje.....	3
Baza ligjore.....	3
Qëllimi i dokumentit.....	4
Metodologjia e përzgjedhjes.....	4
Lista e bimëve invazive.....	5
Ndikimi i bimëve invazive.....	7
Masat e propozuara.....	8
Institucionet përgjegjëse.....	8
Rekomandimet.....	9
Referencat.....	10

## **Hyrje**

Bimët invazive përkufizohen si lloje bimore jo-autoktone apo të huaja të cilat pas hyrjes në një territor jashtë arealit të tyre natyror, përhapen me shpejtësi dhe shkaktojnë ose kanë potencial të shkaktojnë ndikime të dëmshme në biodiversitet, ekosisteme, ekonomi dhe/ose shëndetin e njeriut. Këto lloje karakterizohen me aftësi të lartë riprodhuese, përshtatshmëria ndaj kushteve të ndryshme mjedisore në habitatin e ri, faktorë të cilët u mundësojnë atyre të dominojnë ndaj florës vendore.

Si rezultat, ato mund të shkaktojnë zhvendosjen ose zhdukjen graduale të llojeve autoktone, të ndryshojnë strukturën dhe funksionimin e ekosistemeve, si dhe të ndikojnë negativisht në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Në aspektin ekonomik, bimët invazive mund të shkaktojnë humbje në sektorë si bujqësia, pylltaria dhe menaxhimi i tokës, ndërsa në disa raste paraqesin edhe rrezik për shëndetin publik përmes efekteve alergjike ose toksike.

## **Baza ligjore**

Ky propozim mbështetet në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës *Nr. 03/L-233*, neni 91, i cili ndalon futjen e llojeve të egra të huaja në natyrë në territorin e Republikës së Kosovës dhe në ekosistemet në të cilat ato natyrshëm nuk jetojnë.<sup>1</sup>

Po ashtu në legjislacionin evropian - Rregulloren për Llojet Invazive *Nr. 1143/2014*, që është një akt ligjor i Bashkimi Evropian përcaktohen masat për parandalimin dhe menaxhimin e hyrjes dhe përhapjes së llojeve të huaja invazive.

Këto dokumente synojnë të mbrojnë biodiversitetin, ekosistemet dhe ekonominë e Bashkimit Evropian nga ndikimet negative të këtyre llojeve.

---

<sup>1</sup> Ligji për Mbrojtjen e Natyrës *Nr. 03/L -233*

## **Qëllimi i dokumentit**

Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë listën e bimëve invazive në territorin e vendit duke identifikuar llojet që paraqesin rrezik për ekosistemet vendore. Gjithashtu, raporti synon të mbrojë ekosistemet lokale dhe llojet autoktone nga ndikimi negativ i këtyre bimëve, të cilat mund të prishin balancën natyrore dhe biodiversitetin. Një tjetër objektivi i rëndësishëm është krijimi i bazës së të dhënave dhe masave për parandalimin dhe kontrollin, të cilat ndihmojnë në kufizimin e përhapjes së llojeve bimore invazive. Në këtë mënyrë, dokumenti shërben si një mjet praktik për menaxhimin e tyre në terren. Po ashtu, synon të harmonizojë politikat kombëtare me standardet dhe legjislacionin ndërkombëtar, duke siguruar që veprimet në nivel vendor të jenë në përputhje me praktikatat më të mira të Bashkimit Evropian.

## **Metodologjia e përzgjedhjes**

Metodologjia e këtij dokumenti bazohet në një qasje të integruar shkencore dhe analitike. Fillimisht, është kryer një analizë e literaturës shkencore dhe studimeve ekzistuese lidhur me bimët invazive, me qëllim kuptimin e shpërndarjes, karakteristikave dhe ndikimeve të tyre në ekosisteme të ndryshme. Gjithashtu, janë zhvilluar konsultime me ekspertë të fushës së botanikës dhe ekologjisë, të cilët kanë ofruar njohuri profesionale dhe vlerësime të specializuara mbi praninë dhe ndikimin e llojeve invazive. Një pjesë e rëndësishme e metodologjisë përfshinë edhe vlerësimin e rrezikut ekologjik dhe ekonomik që këto lloje mund të shkaktojnë, duke marrë parasysh ndikimin në biodiversitet, bujqësi dhe ekosistemet natyrore. Dokumenti mbështetet edhe në referenca nga listat ndërkombëtare të llojeve invazive, të cilat shërbejnë si bazë krahasuese për identifikimin dhe klasifikimin e bimëve invazive në përputhje me standardet globale.

## Lista e bimëve invazive

Në vazhdim është paraqitur lista e bimëve invazive që u identifikimi si rezultat i një procesi të kujdesshëm të analizave shkencore dhe krahasuese. Llojet e përfshira në këtë listë janë vlerësuar në bazë të ndikimit të tyre në ekosistemet vendore, aftësisë për përhapje të shpejtë dhe potencialit për të shkaktuar dëme në biodiversitetin dhe në ekonomi. Klasifikimi i tyre mbështetet në të dhëna nga hulumimet shkencore në teren dhe burime ndërkombëtare të pranuar, duke siguruar një qasje të standardizuar dhe të besueshme. Kjo listë shërben si një bazë referimi për identifikimin, monitorimin dhe menaxhimin e llojeve bimore invazive në vendin tonë.

Nr.	Emri shkencor i llojit	Familja	Forma jetësore	Shtirirja natyrore	Lloji i habitatit
1	<i>Abutilon theophrasti</i> Medik.	<i>Malvaceae</i>	T	Azi (Azi qendore deri në Kinë)	Përgjatë rrugëve
2	<i>Acer negundo</i> L.	<i>Sapindaceae</i>	P	Amerikë (Kanadë deri në Honduras)	Përgjatë rrugëve, në parqe
3	<i>Ailanthus altissima</i> (Mill.) Swingle.	<i>Simaroubaceae</i>	P	Azi (Kinë)	Përgjatë rrugëve, në parqe
4	<i>Amaranthus retroflexus</i> L.	<i>Amaranthaceae</i>	T	Amerikë (Meksikë)	Tokat e kultivuara, përgjatë rrugëve, vende të braktisura, etj.
5	<i>Ambrosia artemisiifolia</i> L.	<i>Asteraceae</i>	T	Amerikë (Amerika subarktike deri në SHBA)	Hekurudha, përgjatë rrugëve
6	<i>Amorpha fruticosa</i> L.	<i>Fabaceae</i>	P	Amerikë (SHBA deri në Meksiken veriore)	Përgjatë rrugëve, vende të braktisura
7	<i>Bidens frondosa</i> L.	<i>Asteraceae</i>	T	Amerikë (Kanadë deri në SHBA)	Bregjet e lumenjve
8	<i>Datura stramonium</i> L.	<i>Solanaceae</i>	T	Amerikë (Teksas deri në Amerikën Qendrore dhe Karaibe)	Përgjatë rrugëve, në tokat e kultivuara, në vende të braktisura, etj.
9	<i>Erigeron canadensis</i> L.	<i>Asteraceae</i>	T	Amerikë	Përgjatë rrugëve, në toka të braktisura, hekurudhave, etj.
10	<i>Erigeron annuus</i> (L.) Desf.	<i>Asteraceae</i>	T	Amerikë (Kanadë deri në SHBA, Nikaragua deri në Panama)	Përgjatë rrugëve, në toka të braktisura, etj.
11	<i>Galinsoga</i>	<i>Asteraceae</i>	T	Amerikë	Tokat e kultivuara, vendet e

	<i>parviflora</i> Cav.			(Meksika deri në Amerikën Tropikale)	braktisura, etj.
<b>12</b>	<i>Helianthus tuberosus</i> L.	<i>Asteraceae</i>	G	Amerikë (Kanadë qendrore dhe lindore deri në SHBA)	Bregjeve të lumenjve, përgjatë rrugëve, vendet e braktisura
<b>13</b>	<i>Impatiens balfourii</i> Hook.f.	<i>Balsaminaceae</i>	T	Azi (Pakistan verior deri në Himalajën perëndimore)	Bregjeve të përrenjve
<b>14</b>	<i>Impatiens glandulifera</i> Royle	<i>Balsaminaceae</i>	T	Azi (Pakistan verilindor deri në Nepal)	Bregjeve të lumenjve
<b>15</b>	<i>Reynoutria × bohemica</i> Chrtek & Chrtková	<i>Polygonaceae</i>	G	Azi (Lindja e Largët e Ruisë deri në Kinë dhe Azinë Lindore)	Përgjatë rrugëve, në vende të braktisura, në bregjet e lumenjve, në tokat e kultivuara
<b>16</b>	<i>Robinia pseudoacacia</i> L.	<i>Fabaceae</i>	P	Amerikë (SHBA qendrore-lindore dhe lindore)	Përgjatë rrugëve, në bregjet e lumenjve dhe në vende të braktisura, etj, ndërsa ka depërtuar gjithashtu edhe në pyjet me dushk dhe ah
<b>17</b>	<i>Senecio inaequidens</i> DC.	<i>Asteraceae</i>	Ch	Afrikë (Afrikën jugore)	Përgjatë rrugëve, në vende të braktisura
<b>18</b>	<i>Solidago gigantea</i> Aiton.	<i>Asteraceae</i>	H	Amerikë (Kanadë deri në Meksikën verilindore)	Bregjet e lumenjve, përgjatë rrugëve
<b>19</b>	<i>Sorghum halepense</i> (L.) Pers.	<i>Poaceae</i>	G	Azi (Makaronezia deri në Azinë Qendrore dhe Indo-Kinë)	Përgjatë rrugëve, në tokat e kultivuara
<b>20</b>	<i>Xanthium spinosum</i> L.	<i>Asteraceae</i>	T	Amerikë (Kanada qendrore dhe lindore deri në Meksikë, Peruja deri në Amerikën jugore)	Përgjatë rrugëve, në vende të braktisura

Fig. 1 Lista e bimëve invazive<sup>2</sup>

Shkurtesat: T - Terofite, P - Fanerofite, G - Gjeofite, Ch - Kamefite, H - Hemicriptofite

<sup>2</sup> Invasive alien plant species (IAPS) in the eastern region of Kosovo: A preliminary list. Bujar Kadriaj, Naim Berisha, Elez Krasniqi, Fadil Millaku. University of Prishtina "Hasan Prishtina", Faculty of Mathematics and Natural Sciences, Department of Biology, St. "George Bush", No. 31, 10000, Prishtina, KOSOVO

## **Ndikimi i bimëve invazive**

Degradimi i habitateve natyrore përfaqëson një ndër sfidat më të rëndësishme mjedisore bashkëkohore, i cili intensifikohet ndjeshëm nga përhapja e bimëve invazive. Këto lloje, të futura qëllimisht ose në mënyrë aksidentale jashtë arealit të tyre natyror, karakterizohen nga aftësia e lartë për përhapje dhe konkurrencë, duke shkaktuar ndryshime të thella në strukturën dhe funksionimin e ekosistemeve vendore. Si rezultat, ato kontribuojnë në degradimin progresiv të habitateve, duke zëvendësuar florën vendore dhe duke ulur diversitetin biologjik.

Një ndër pasojat kryesore të këtij fenomeni është zhvendosja e llojeve vendore, të cilat përballen me konkurrencë të ashpër për burime jetike si drita, uji dhe lëndët ushqyese. Në shumë raste, kjo çon në marginalizimin ose zhdukjen lokale të tyre, duke shkaktuar çekuilibra ekologjikë dhe ndërprerje të proceseve natyrore, përfshirë zinxhirët ushqimorë dhe marrëdhëniet simbiotike.

Ndikimet e bimëve invazive shtrihen gjithashtu në sektorët ekonomikë, veçanërisht në bujqësi dhe pylltari, ku ato shkaktojnë humbje të konsiderueshme. Përhapja e tyre në tokat bujqësore ul rendimentin e kulturave për shkak të konkurrencës për burime dhe rrit kostot e menaxhimit për shkak të nevojës për masa kontrolli dhe eliminimi. Në sektorin pyjor, ato pengojnë rigjenerimin natyror të pyjeve dhe dëmtojnë cilësinë e ekosistemeve pyjore, duke ndikuar negativisht në prodhimtarinë dhe funksionet mbrojtëse të tyre.

Bimët invazive mund të paraqesin rreziqe për shëndetin publik në mënyra të ndryshme. Disa lloje janë alergjike ose toksike, duke shkaktuar reaksione tek njerëzit dhe kafshët, ndërsa të tjera krijojnë kushte të favorshme për përhapjen e sëmundjeve. Gjithashtu, ndikimi i tyre në cilësinë e ujit dhe tokës mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta në shëndetin dhe mirëqenien e popullatës.

## **Masat e propozuara**

Menaxhimi efektiv i bimëve invazive përbënë një komponent thelbësor të politikave bashkëkohore për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit. Një nga shtyllat kryesore në këtë drejtim është parandalimi i futjes së llojeve të bimëve invazive. Kjo mund të arrihet përmes forcimit të kontrolleve kufitare, zbatimit rigoroz të kuadrit ligjor dhe vlerësimit paraprak të rrezikut ekologjik që mund të paraqesin këto lloje. Kjo qasje parandaluese konsiderohet më efektive dhe më pak e kushtueshme sesa ndërhyrjet pas përhapjes së tyre. Paralelisht me këtë, monitorimi i vazhdueshëm dhe raportimi sistematik i përhapjes së bimëve invazive janë të domosdoshme për identifikimin e hershëm të pranisë së tyre dhe për ndërmarrjen e masave të shpejta. Krijimi i bazës së integruara të të dhënave dhe bashkëpunimi ndërinstytucional kontribuojnë në përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e këtij fenomeni në mënyrë të koordinuar dhe efikase. Kontrolli dhe eliminimi i llojeve problematike përbëjnë një tjetër element kyç, duke përfshirë përdorimin e metodave mekanike, biologjike dhe kur është e nevojshme, kimike, në përputhje me standardet mjedisore dhe parimet e qëndrueshmërisë. Këto masa synojnë kufizimin e përhapjes së tyre dhe rikthimin gradual të habitateve në gjendjen e tyre natyrore.

## **Institucionet përgjegjëse**

Në kuadër të menaxhimit dhe adresimit të çështjeve mjedisore, një rol të rëndësishëm luajnë institucionet përgjegjëse në nivele të ndryshme të qeverisjes dhe organizimit shoqëror. Në këtë drejtim, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përfaqëson autoritetin qendror përgjegjës për hartimin e politikave, strategjive dhe kuadrit ligjor në fushën përkatëse, duke siguruar koordinimin ndërinstytucional dhe zbatimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare për mjedisin dhe natyrën.

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit vepron si institucion mbështetës, duke u angazhuar në monitorimin e gjendjes së mjedisit dhe natyrës, vlerësimin e ndikimeve dhe raportimin e të dhënave relevante, të cilat shërbejnë si bazë për vendimmarrje të informuar. Ajo gjithashtu luan një rol kyç në zbatimin e politikave mjedisore dhe në mbikëqyrjen e aktiviteteve që mund të kenë ndikim në biodiversitet.

Institucionet kërkimore dhe akademike kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme përmes zhvillimit të studimeve shkencore, analizave dhe projekteve kërkimore, duke ofruar ekspertizë profesionale dhe zgjidhje inovative për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Roli i tyre është thelbësor në avancimin e njohurive dhe në mbështetjen e politikëbërjes së bazuar në evidencë.

Në nivel vendor, autoritetet lokale kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë në zbatimin praktik të politikave dhe masave mjedisore, duke qenë më pranë komuniteteve dhe problematikave konkrete. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e territorit, ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe në ndërmarrjen e iniciativave lokale për mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe biodiversitetit, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

## **Rekomandimet**

Miratimi i kësaj liste konsiderohet një hap strategjik në funksion të mbrojtjes së biodiversitetit dhe promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë drejtim, sugjerohet që lista të përditësohet në mënyrë periodike dhe të integrohet plotësisht në politikat kombëtare të mjedisit, duke siguruar një qasje dinamike dhe të përshtatshme ndaj zhvillimeve të reja.

Gjithashtu duhet që identifikimi, monitorimi dhe menaxhimi i bimëve invazive të trajtohen si komponentë thelbësorë e politikave për mbrojtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, për arritjen e këtij qëllimi, është e nevojshme të ndërmerren këto masa prioritare:

- Identifikimi sistematik i llojeve invazive dhe vlerësimi i rrezikut që ato paraqesin;
- Monitorimi i vazhdueshëm dhe raportimi i përhapjes së tyre në nivel lokal dhe qëndor;
- Hartimi dhe zbatimi i masave efektive për kontrollin dhe eliminimin e llojeve invazive;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional dhe koordinimi i aktiviteteve përkatëse;
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të institucioneve përgjegjëse, me qëllim ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe efektive për menaxhimin e llojeve invazive duke i konsideruar këto si elemente kyçe për adresimin afatgjatë të problematikës me bimët invazive; Rëndësi e veçantë duhet ti kushtohet ndërgjegjësimit publik dhe forcimit të informimit të komuniteteve lokale mbi rreziqet dhe mënyrat e parandalimit të llojeve invazive;

## Referencat

- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;
- Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës;
- Udhëzimin Administrativ MEA – *Nr.12/2020* për Llojet e Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura;
- Raporti për Gjendjen e Natyrës 2018 – 2021;
- Publikimi shkancor: Bujar Kadriaj, Naim Berisha, Elez Krasniqi\*, Fadil Millaku, University of Prishtina “Hasan Prishtina”, Faculty of Mathematics and Natural Sciences, Department of Biology, St. “George Bush”, No. 31, 10000, Prishtina, KOSOVO
- [https://www.missouriplants.com/Abutilon\\_theophrasti\\_page.html](https://www.missouriplants.com/Abutilon_theophrasti_page.html)